



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TE FURNIZIMIT
ME UJE DHE LARGIMIT E PERPUNIMIT
TE UJERAVE TE NDOTURA



V E N D I M

Nr. 37 date 19/12/2011

Per miratimin e tarifave te ujit per konsum publik
per Sha UK Shkoder

Ne mbeshtetje te nenit 14 dhe 21, te Ligjit Nr. 8102 date 28.03.1996 " Per Kuadrin Rregullator te Sektorit te Furnizimit me Uje dhe Largimit e Perpunimit te Ujrave te Ndotura ", i ndryshuar, si dhe Metodikes "Mbi vendosjen e tarifave te ujit per konsum publik" ne zbatim te ketij Ligji, Komisioni Kombetar Rregullator i ERRU- it

V E N D O S I :

1. Te miratoje tarifat e ujit per konsum publik per SH.a.UK Shkoder si me poshte:

	Per ujin e pijshem	Per ujrave te ndotura
Konsumator familjar:	40 lek/m ³	15 lek/m ³
Institucione buxhetore:	110 lek/m ³	20 lek/m ³
Ente private:	110 lek/m ³	20 lek/m ³

2. Tarife fikse sherbimi 100 lek/muaj/klient

3. Pagesa rregullatore do te jete 0,8 % e te ardhurave vjetore te llogaritura.

4. Ky vendim hyn ne fuqi 01.01.2012 dhe eshte i vlefshem deri ne miratimin e tarifave te reja.

KRYETARI

AVNI DERVISHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT
TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR**

VENDIM

Nr 25 , datë 30.03.2018

PËR

**MOSMARRJEN NË SHQYRTIM TË APLIKIMIT PËR MIRATIMIN E TARIFAVE
TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA PËR
SHOQËRINË UJËSJELLËS KANALIZIME SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, VKM nr. 63, datë 27.01.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë dhe të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 09.12.2015 "Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 09.12.2015 "Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit të ujërave të ndotura", vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 09.12.2015 "Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit të ujërave të ndotura" dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 09.12.2015 "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimit të ujërave të ndotura", pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi aplikimin e shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a. për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura, Komisioni Kombëtar Rregullator,

Konstatoi se:

- Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Shkodër është licencuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator me vendimin nr.55, datë 29.12.2017, "Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës Kanalizime Shkodër".
- Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Shkodër me anë të shkresës nr. 739 prot. datë 30.06.2017 ka aplikuar për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura.
- Dosja e aplikimit u paraqit me mungesa në dokumentacion si "Vendimi i Këshillit Bashkiak si opinion për tarifën e reja të propozuara", "Raporti i ekspertit kontabël", "Procesverbali i seancës dëgjimore me publikun" dhe "Modeli i aplikimit" dhe u plotësua pjesërisht vetëm pas insistimit të Entit Rregullator të Ujit.

- Edhe pas kërkesave të Entit Rregullator të Ujit, "Vendimi i Këshillit Bashkiak si opinion për tarifën e reja të propozuara", ende nuk është paraqitur.
- Në mbledhjen e datës 30.03.2018 Komisioni Kombëtar Rregullator analizoi dhe një herë situatën e aplikimeve për ndryshimin e tarifave dhe gjykoj se ka kaluar një periudhë e gjatë bashkëpunimi ku shoqëria UK Shkodër ende nuk është treguar korrekte me plotësimin e dokumentacionit të kërkuar me qëllim vijimin e procedurës nga ERRU.

Për sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të mos marrë në shqyrtim aplikimin e shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Shkodër sh.a. për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura.
2. Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Shkodër detyrohet të aplikojë për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura me dokumentacionin dhe të dhënat e plota, brenda datës 30.06.2018 pasi në të kundërt do të zbatohen saksionet që parashikon ligji në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Ndriçim SHANI